

RREGULLORE E PROMOCIONIT "Frigorifer Samsung + mikser tavoline Tefal"

1. Organizatori i Promocionit

Samsung Electronics Austria GmbH me seli në Vjenë në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri dhe numër regjistrimi FN 217924b (në vijim "Samsung"), organizon promocionin për blerjen e frigoriferëve Samsung përcaktuar në pikën 7 të kësaj Rregulloreje (në vijim referuar veçmas si: **Pajisja**, dhe bashkërisht si: **Pajisjet**).

Me termin blerës përkufizohen personat fizik dhe personat juridik me rezidencë ose seli të regjistruar në territorin e Republikës së Kosovës, të cilët blejnë Pajisjet për nevojat e tyre dhe jo për shitje të mëtejshme.

2. Periudha e promocionit

Promocioni i mësipërm vlen për blerësit e Pajisjeve në territorin e Republikës së Kosovës për periudhën nga 01.07 deri 31.07.2020, ose deri sa të përfundojë stoku, në përputhje me parashikimet e kësaj Rregulloreje (në vijim: **Rregullorja**).

3. Dhurata

Nëse përmbushen të gjitha kushtet e parashikuara në këtë Rregullore, blerësi i Pajisjes ka të drejtë të përfitojë si dhuratë një "Mikser tavoline Tefal Wizzo QB300138" (në vijim: **Dhurata**).

4. Kushtet për pjesëmarrjen në promocion

Për të marrë pjesë në promocion dhe për të fituar të drejtën për Dhuratën, duhet të përmbushen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet vijuese:

- a. Blerësi blen Pajisjen e përcaktuar në pikën 7 të kësaj Rregulloreje brenda periudhës së promocionit;
- b. Pajisja blihet pranë partnerit të autorizuar të shitjes Samsung në territorin e Republikës së Kosovës; Lista e partnerëve të autorizuar të shitjes Samsung përcaktohet në pikën 6 të kësaj Rregulloreje;
- c. Blerësi regjistron me sukses Pajisjen duke dërguar një e-mail në adresën ce.promo@samsung.com, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në pikën 5 të kësaj rregulloreje.

5. Procedura dhe afatet për regjistrimin e pajisjes

Parakushti për pjesëmarrjen në promocion dhe fitimin e të drejtës për të përfituar Dhuratën është regjistrimi i Pajisjes në përputhje me këtë Rregullore.

Regjistrimi i Pajisjes kryhet duke dërguar një e-mail në adresën ce.promo@samsung.com.

Duhet që blerësi të kryejë regjistrimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e blerjes së Pajisjes.

Mund të regjistrohen vetëm Pajisje Samsung të cilat janë blerë brenda periudhës së promocionit nga 01.07 deri 31.07.2020 pranë njërit prej partnerëve të autorizuar të shitjes të Samsung.

Nëse të gjitha kushtet e pikës 4 të kësaj Rregulloreje përmbushen rregullisht dhe nëse regjistrimi kryhet me sukses, blerësi ka të drejtë të përfitojë Dhuratën. Dhurata do të dërgohet në adresën e banimit (pa shpenzime transporti) brenda 45 deri 60 ditëve nga data e regjistrimit të suksesshëm.

Procedura e regjistrimit kërkon dërgimin e të dhënave të mëposhtme të blerësit, të nevojshme për regjistrimin e suksesshëm:

- Emrin dhe mbiemrin e personit fizik, ose emrin e personit juridik nëse blerësi është person juridik;
- Adresën e e-mailit të blerësit;
- Adresën e saktë të banimit në territorin e Republikës së Kosovës (për dorëzimin e Dhuratës);
- Numrin e telefonit (për të kontaktuar lidhur me dorëzimin e Dhuratës);
- Kopje e skanuar e faturës tatimore lëshuar nga pika e shitjes për të konfirmuar regjistrimin;
- Modelin dhe numrin serial të Pajisjes.

Samsung do të kontrollojë nëse data e shitjes korrespondon me periudhën e Promocionit dhe nëse janë përmbushur kushtet e tjera të përcaktuara në këtë Rregullore. Me dërgimin e e-mailit për regjistrim, blerësi jep pëlqimin e shprehur për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të tij personale në përputhje me parashikimet e kësaj Rregulloreje.

Nëse plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara në këtë Rregullore, blerësit do t'i dërgohet Dhurata në adresën e banimit brenda 45 deri 60 ditëve nga momenti i regjistrimit të suksesshëm, për të cilin blerësi do të njoftohet nëpërmjet një e-maili në adresën e e-mailit të deklaruar gjatë regjistrimit.

Blerësi është i detyruar që gjatë regjistrimit të paraqesë të dhëna të sakta dhe të plota. Organizatori nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi në rast se të dhënat e depozituara janë të pasakta, ose depozitohen jashtë afatit. Nëse regjistrimi nuk kryhet brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullore ose nëse të dhënat e dërguara për efekt regjistrimi nuk janë të sakta, blerësi nuk do të ketë të drejtë të përfitojë Dhuratën.

6. Lista e partnerëve të autorizuar të shitjes të Samsung

NEPTUN XK
GAMA
ELKOS
AZ TECH

7. Përcaktimi i Pajisjes

Model code	PJT
RS68N8240S9/EF	RS8000
RS68N8240WW/EF	RS8000
RS68N8240B1/EF	RS8000
RS68N8671SL/EF	RS8000

8. E drejta e ndryshimeve dhe hyrja në fuqi

Samsung rezervon të drejtën që në çdo kohë dhe për arsye të justifikuara të ndryshojë këtë Rregullore me detyrimin për të publikuar këto ndryshime pa vonesa.

Kjo Rregullore publikohet në faqen e internetit të Samsung www.samsung.com/al/offer/rs8000-promo-xk më datë 01.07.2020, datë nga e cila hyn në fuqi.

NJOFTIM PËR MBLEDHJEN DHE PËRDORIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Samsung Electronics Austria GmbH me seli në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri (në vijim referuar si "**Kontrolluesi**"), nëpërmjet këtij njoftimi ju informon lidhur me përpunimin e të dhënave personale si vijon.

1. Kontrolluesi dhe përpunuesi i të dhënave personale

Kontrolluesi i të dhënave personale është Samsung Electronics Austria GmbH me seli në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri, nëpërmjet degës së saj Samsung Electronics Austria GmbH dega Kroaci (në vijim referuar si "**Kontrolluesi**").

Përpunuesi i të dhënave personale është Samsung Electronics Austria GmbH dega Kroaci.

2. Të dhënat personale që do të mblidhen

Kontrolluesi do të mbledhë dhe përpunojë të dhënat personale të mëposhtme:

- Emër dhe mbiemër,
- Adresa e banimit e blerësit,
- Numri i telefonit i blerësit,
- Adresa e e-mailit e blerësit,
- Modeli dhe numri serial i Pajisjes së blerë.

(në vijim referuar bashkërisht si: **të Dhënat Personale**).

3. Qëllimi i mbledhjes i të Dhënave Personale

Kontrolluesi do të mbledhë dhe përpunojë të Dhënat Personale të mësipërme ekskluzivisht me qëllim përcaktimin e përbushjes së kushteve për pjesëmarrjen në promocionin "Frigorifer Samsung + mikser tavoline Tefal Wizzo" dhe për dërgimin e Dhuratës nëse blerësi fiton të drejtën për ta përfituar.

4. Mënyra e përdorimit të të Dhënave Personale

Të dhënat Personale të cilat mblidhen bazuar në pëlqimin e dhënë, do të përdoren ekskluzivisht për qëllimet e sipërpërmendura të Kontrolluesit, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (**Ligji**) dhe Politikat e Privatësisë të Kontrolluesit, bashkëngjitur.

5. Baza ligjore për përpunimin e të Dhënave Personale

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të Dhënat Personale bazuar në pëlqimin e lirë të personit të cilit i referohen këto të dhëna personale.

6. Afati i ruajtjes së të Dhënave Personale

Të Dhënat Personale do të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për të përbushur qëllimin e mësipërm, dhe në çdo rast, jo më tepër se 6 muaj nga data e blerjes.

7. Të drejtat tuaja

Me kërkesë të pjesëmarrësit, Kontrolluesi do të plotësojë, ndryshojë, përditësojë dhe fshijë të Dhënat Personale nëse këto të dhëna janë të paplota, të pasakta ose të papërditësuara dhe nëse përpunimi nuk është në përputhje me Ligjin ose nëse qëllimi i mbledhjes së të dhënave është përbushur. Për më tepër informacion ju lutem lexoni Politikat e Privatësisë tonat ose na kontaktoni me e-mail në adresën dataprotection.sead@samsung.com.

Nëse pjesëmarrësi mendon se përpunimi i të Dhënave Personale të tij dhuron privatësinë e tij, ai mund t'i drejtohet Kontrolluesit të të Dhënave Personale ose Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të kërkuar shpjegime.

8. Informacione të tjera

Për informacione të detajuara lidhur me masat e marra për mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe me transferimin e të Dhënave Personale, ju lutem lexoni Politikën e Privatësisë tona.